

Ne fokus/ Tifozet i kerkojne lojtareve te Tiranes te heqin fanellat

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 02 Nentor 2013 18:04



Humbja e radhes ne shtepi nuk eshte pranuar nga tifozet e Tiranes. Te acaruar nga paraqitjet e dobta qe skuadra po ben dhe nga pozitat e renduara ne fundin e tabelës, tifozet bardheblu kane protesuar pas ndeshjes me Flamurtarit. “Fanatics” i kane kerkuar lojtareve te heqin fanellat nga trupi dhe te mos shkelin me ne stadium. Eshte dashur nderhyrja e policise qe tifozet te mos konfrontohen me lojtaret jashte dyerve te stadiumit.